



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 5, Datë 29.12.2014

PËR

IDENTIFIKIMIN E ZONAVE TË URBANIZUARA NË TË GJITHË TERRITORIN E  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MIRATIMIN E HARTAVE KU MUND TË  
NDËRHYHET NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT URBAN

Në mbështetje të neneve 5, 7, 9, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” dhe të VKM-së Nr. 877, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Identifikimin e zonave të urbanizuara në bazë të studimit të gjendjes faktike të ndërtimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas hartave bashkëlidhur;
2. Përcaktimin e këtyre zonave si zona të ndërtueshme, ku mund të ndërhyhet me ndërtime në kuadër të zhvillimit urban;
3. Në rastet kur më shumë se 50 % e sipërfaqes së parcelës shtrihet brenda zonës së urbanizuar, e gjithë sipërfaqja e parcelës konsiderohet sipërfaqe e ndërtueshme;
4. Ngarkohen Autoritetet e Planifikimit dhe Zhvillimit që, deri në hartimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Planeve Vendore për njësitë e reja territoriale, **t’i japin prioritet mbushjes urbane të zonave të identifikuar si të ndërtueshme, duke shfrytëzuar infrastrukturën ekzistuese dhe duke respektuar përdorimin aktual të tokës;**
5. Ngarkohen Autoritetet e Zhvillimit për miratimin e propozimeve për ndërtim brenda zonave të identifikuar më sipër, me kusht plotësimin e pikës 7 të këtij vendimi, për këto raste:
  - a) **të gjitha rastet (përjashtimore)**, listuar në pikën 4 të vendimit të KKT-së Nr.1, datë 22.08.2014;
  - b) **banesa individuale / njëfamiljare**, kërkuar nga pronari i truallit për strehimin primar të tij<sup>1</sup>, me sipërfaqe totale ndërtimi deri në 250 m<sup>2</sup>;

<sup>1</sup> Këtu **përfshihen vetëm** rastet kur ndërtimi kërkohet për qëllime strehimi të pronarit të truallit. Këtu **nuk përfshihen** rastet kur ndërtimi kërkohet për banesa të dyta, apo për qëllime biznesi.



- c) **shtesa në banesa individuale/ njëfamiljare ekzistuese**, deri në masën 50 % të sipërfaqes së tyre totale të ndërtimit.
6. Ngarkohen Autoritet e Zhvillimit për miratimin e zhvillimeve urbane brenda zonave të identifikuar më sipër, **për të gjitha kategoritë e bonitetit të tokës bujqësore**, me kusht plotësimin e pikës 7 të këtij vendimi;
  7. Deri në hartimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Planeve Vendore për njësitë e reja territoriale, **propozimi për ndërtim brenda zonave të identifikuar më sipër të miratohet vetëm pas konfirmimit nga AKPT dhe informimit të Këshillit Kombëtar të Territorit lidhur me konformitetin e zhvillimit të propozuar me instrumentet kombëtare dhe/ose vendore të planifikimit të miratuara ose në proces, me vendimet e KKT-së, si edhe me legjislacionin sektorial në fuqi.**
  8. Çdo leje ndërtimi, e miratuar pas datës së miratimit të këtij vendimi, në kundërshtim me përcaktimet e pikave 4, 5, 6 dhe 7 të tij, konsiderohet nul dhe e pavlefshme.
  9. Konvertimi nga tokë “arë” në tokë “trull” për sipërfaqet brenda zonave të urbanizuara do të bëhet sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
  10. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të veprojë si zyrë shërbimi me një ndalesë për kontrollin e përputhshmërisë së kërkesave për leje ndërtimi me qëllim lehtësimin e procesit të bashkërendimit me të gjitha autoritetet qendrore dhe vendore për realizimin e investimit.
  11. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe të gjitha Autoritetet Vendore të Planifikimit e Zhvillimit për zbatimin e këtij Vendimi.
  12. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT**



**Z. EDMOND PANARITI**

**MINISTËR I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**

**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**

**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**

